



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 10.06.2024)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 3. Emona Muçi | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 5. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*; anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli, znj. Gentiana Muçaj dhe z. Klodian Kurushi.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

3. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 299, datë 05.06.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar””, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e datës 10.06.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor me rend dite shqyrtimin e projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 299, datë 05.06.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar””, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Për më tej fjalën relatorit.

Alban Toro: Faleminderit!

Siç jeni në dijeni, më herët me vendimin nr. 299, 05.06.2024 nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është përpunuar kërkesa më datë 31.05.2024 të kryer nga Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për caktim gjyqtari përkatësisht të një trupe treshe për gjykimin e një çështjeje me nr. kërkesë 766 dhe nr. 31.

Natyrisht formula e propozuar në rastin konkret ka qenë akti normativ për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershëm duke kërkuar paraprakisht ekzistencën e disa kritereve në caktimin e kësaj tresheje siç ishte: treshja duhet të kishte përkatësi në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm apo të kishte një përvojë

profesionale 10-vjeçare ku 5 vjet në fushën penale, dhe mbi të gjitha të kishte kaluar me sukses procesin e vlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/2016.

Ndërkohë që është kryer procedura e komunikimit, nga disa nga anëtarët e treshes së caktuar me short elektronik rezulton të jenë paraqitur disa kërkesa, ku për nga përkatësia po e filloj me zonjën {...} e cila ka bërë me dije jo vetëm Këshillin e Lartë Gjyqësor por edhe kryetares së gjykatës, ku në përmbajtje rezulton se: “Rezulton se kam qenë anëtare e trupit gjykues në shkallë të parë për këtë çështje dhe jam shprehur me vendimin nr. 59, datë 28.09.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”.

Natyrisht, duke marrë si shkak pengues në përbërjen e trupit gjykues nga ana e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në datën datë 10.06.2024, është kërkuar plotësimi i trupit gjykues për shkak se titullarja ka pranuar si shkak të ligjshëm kërkesën për tërheqje të zonjës {...}.

Ndërkohë, paraprakisht në datën 08.06.2024 përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur një ankim administrativ i znj. {...}, me objekt: “Shfuqizimin/Ndryshimin e pjesshëm të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 299, 05.06.2024, për caktimin tim për të gjykuar në një gjykatë të ndryshme nga ajo në të cilën ushtroj funksionin, konkretisht në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak se nuk duhej të isha përfshirë në listën e gjyqtarëve për të cilët lejohet në rastin konkret delegimi për një çështje të veçantë.”.

Në argumentimin e saj ajo vijon se: “...pa dashur t’i shmangem përgjegjësisë time funksionale dhe ushtrimit të detyrës, detyrohem në rastin konkret t’iu investoj nëpërmjet këtij ankimi administrativ, duke iu kërkuar ndryshimin e pjesshëm të vendimit tuaj, pasi ndodhemi para një dispozite ndaluese/urdhëruese të ligjit për ndalimin e delegimit tim, në një gjykatë tjetër, qoftë edhe për të gjykuar një çështje të veçantë, pasi e kundërta do të vinte në rrezik të gjithë procesin e rregullt gjyqësor, në lidhje me gjykatën e caktuar me ligj. Sjell në vëmendjen tuaj se në këtë rast ky mekanizëm është i vetmi që mund të sjellë situatën në kushtet e ligjshmërisë, pasi për shkakun e mësipërm nuk mund të paraqes kërkesën time për dorëheqje, sepse kjo situatë nuk lidhet me kërkesat e nenit 17 të K.Pr.Penale, sepse në dijeninë time nuk kam asnjë shkak për të qenë apo dukur i njëanshëm.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka për detyrë miradministrimin e drejtësisë, e në këtë aspekt duhet të zbatojë standarde të njëjta vendimmarrje e qëndrimi në rastet kur i kërkohet plotësimi i

trupës gjykuese me gjyqtarë të gjykatave të tjera të ndryshme nga gjykata që ka nevojë për këtë plotësim. Në këtë aspekt, neni 4 pika 4 e ligjit 115/2016, për gjyqtarin që ka ushtruar mandatin e anëtarit të KLGJ-së përbën të drejtë materiale, në kuptim të nenit 109/d të K.Pr.Administrative, mosrespektimi i së cilës pasjell paligjshmërinë e aktit administrativ.”.

Natyrisht, duke vlerësuar kërkimet e të dy, si të kryetares së gjykatës së posaçme, ashtu edhe të zonjës {...}, ju propozohet të ndryshohet vendimmarrja, konkretisht nr. 299, 05.06.2024, e Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi gjyqtarja zonja Goxha ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë dhe kjo është e dukshme, sipas nenit 15 e vijues të K.Pr.Penale dhe i është pranuar kërkesa për heqje dorë nga zëvendëskryetarja e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ndërkohë që në rastin e zonjës {...} ju propozohet largimi i saj nga trupi gjykues për shkak të qëndrimeve konstante të mbajtura nga Këshilli të cilët tashmë përbëjnë edhe siguri juridike për fakte të njëjta juridike.

Kështu që, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është vendi për ndryshimin e vendimit nr. 299, datë 05.06.2024, për sa i përket 2 gjyqtareve të cilët kanë investuar Këshillin, pra konkretisht znj. {...} dhe znj. {...}, për gjykimin e çështjes penale si më lart.

Për gjyqtarët që duhen të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke mbajtur në konsideratë propozimet që kemi paraqitur në seancën paraprake të datës 05.06.2024 dhe si rezultat të shortit të zhvilluar si e tillë mbetet në trup gjykues znj. {...}, tashmë në cilësinë e relatores, si dhe do të zhvillohet shorti për plotësimin e trupit me 2 (dy) anëtarë të tjerë.

Pra ju propozohet të përzgjidhen me short 2 (dy) gjyqtarë, ndërmjet gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që plotësojnë kriteret: dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat pesë në çështjet penale, si dhe të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016.

Përfundimet nga shorti

Ju propozohet titullarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm: znj. {...}, si edhe gjyqtarët që kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Nëse nuk kemi ndonjë propozim ftoj stafin të hedhë shortin.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Toro për relatimin.

Ka diskutime për sa u parashtrua nga z. Toro në lidhje me përjashtimin e magjistratëve për t'u bërë pjesë e këtij shorti dhe mënyrën e hedhjes së shortit?

(Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime ftoj administratën të vijojë me hedhjen e shortit.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa e përcjellë me e-mailin e datës 10 qershor 2024), gjyqtarët e përzgjedhur janë Lutfije Celami dhe Dritan Hasani.

Ilir Rusi: Ju faleminderit!

Me hedhjen e shortit e deklaroj të mbyllur mbledhjen e sotme.

Javë të mbarë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor